

## ANALIZA GJUHËSORE E VEPRËS SË SAMI FRASHËRIT “TAAŞŞUK-Ï TAL’AT VE FITNAT”

### Hyrje

Vepra e parë e Sami Frashërit<sup>[1]</sup> “**Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat**” (Dashuria e Talatit me Fitnetin)<sup>[2]</sup> njëherësh është romani i parë në letërsinë turke. Samiu këtë vepër e shkroi kur i kishte 21 vjet. Për herë të parë është botuar më 1872 në gjuhën turke-osmane. Fillimisht u botua në tri pjesë dhe lajmin për daljen e pjesës së parë e kishte dhënë gazeta “Basiret” e datës 18 nëntor 1872. Po e njëjta gazetë, më vonë lajmëron edhe për daljen e pjesës së dytë dhe të tretë. Romani zgjoi interesim ndër intelektualët turq, prandaj u ribotua edhe dy herë në Turqi, më 1964 dhe më 1979, tani i transkriptuar me shkrimin latin nga dr. Sedit Yükseli. Qëllimi ynë këtu është që këtë vepër ta analizojmë nga aspekti gjuhësor.

### Këtë e bëjmë për tri arsye kryesore:

1. Vepra është shkruar para njëqind e tridhjetepesë vitesh;
2. autori i veprës ka shqipen – gjuhën shqipe gjuhë amtare, e cila dallohet në shumë pika nga gjuha turke; dhe
3. vepra nuk është trajtuar gjerësisht nga aspekti gjuhësor, me sa kemi dijeni.

---

[1] Për bibliografinë e plotë të veprave të Sami Frashërit shih: Zymber Bakiu, Vepra 8, Rilindja, 1978 dhe A.S. Levend, Sami Frashëri, Tiranë 2004. Ndërkaq, vepra më e plotë e tij në gjuhën shqipe është botimi i Logos-it, Shkup, 2004, që përfshin 20 vepra.

[2] Në gjuhën shqipe e përkthyen Mehdi Polisi dhe Ruzhdi Lata, Rilindja, Prishtinë, 1984. Është ribotuar edhe disa herë në Tiranë (1993) dhe në Shkup (2002; 2004).

## I - ANALIZA LEKSIKORE

Analiza leksikore e një vepre të shkruar gati para një shekulli e gjysmë është me interes të veçantë gjuhësor, sepse përfaqëson nivelin e gjuhës së asaj periudhe. Edhe romani "*Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat*" i shkruar, siç u përmend edhe më lart, më 1872, shikuar nga ky aspekt meriton një trajtim të veçantë, sidomos kur kemi parasysh faktin se një studim i hollësishëm deri tash nuk është bërë.

Nga analiza e gjithanshme leksikore që ia kemi bërë veprës në fjalë, kemi vënë re se leksiku i kësaj vepre është i larmishëm. Aty gjejmë fjalë të shumta të burimit arab, persian, turk, por aty-këtu edhe fjalë të huazuara nga gjuhët europiane. E tëra kjo, në një mënyrë, tregon shkallën e njohjes së mirë të këtyre gjuhëve nga ana e autorit të saj, Sami Frashërit. Meqenëse një shumësi fjalësh janë huazime arabe e persiane, është e arsyeshme të jepet përgjigje në disa pyetje: Pse pikërisht kaq shumë huazime të përdorura në këtë vepër të kësaj periudhe? Çfarë kategorish të fjalëve arabe e persiane janë përdorur më së shumti? A kanë prishur sistemin gramatikor të turqishtes, domethënë sa i janë përshtatur natyrës së gjuhës turke? etj.

Dihet fare mirë se kontaktet e një populli me popullin tjetër rezultojnë me ndikime nga më të ndryshmet, prandaj edhe me ndikime gjuhësore. Kontaktet e turqve me arabët e persianët janë shumë të hershme. Gjuha arabe, si gjuhë e Islamit dhe si gjuhë e shkencës përgjithësisht, (Sapiri), nga njëra anë, dhe gjuha persiane si gjuhë e traditës poetike-letrare, nga ana tjetër, kanë ndikuar thellësisht në gjuhën turke në të gjitha rrafshet, prandaj edhe në rrafshin leksikor. Këtij ndikimi kaq të madh leksikor arab e persian në gjuhën turke nuk ka mundur t'i shpëtojë as Sami Frashëri, sado që Samiu në shkrimet e tij të mëvonshme mban qëndrim të rreptë për pastrimin e gjuhës turke nga elementet e huaja. Në këtë punim do të shohim konkretisht si qëndron puna në romanin "*Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat*" nga aspekti gjuhësor.

Kjo vepër është mjaft e ngarkuar me huazime arabe e persiane. Ato këtu kapin gati të gjitha kategoritë leksiko-gramatikore: emra (ku hyjnë edhe participët dhe infinitivët arabë), mbiemra, përemra, ndajfolje, lidhëza, parafjalë etj. Emrat zënë vendin e parë, sepse, duke shprehur nocione të ndryshme, huazohen më lehtë (Tljavini).

Për të pasur një ide më të qartë lidhur me këtë, sa për ilustrim, po shkëpusim një paragraf:

“Zirde zikr olunacak hikayenin mealinden anlaşılacağına göre afitab-ı aşk u muhabbetin henüz sinn-i ruşde varmamış sibyanın kulübüne dahi tulu’ edebildiği kariin garabet ve taaccübünü mucib olmasın.Çünkü, aşk bir emr-i tabiidir ki nev’i beni Adem’in her bir kısmında, yani erkeğinde dışısında, ufağında büyüğünde, sabisinde baliğında, gencinde ihtiyarında, fakirinde zengininde, akilinde gabisinde, aliminde cahilinde, medenisinde bedevisinde zuhur eder.”<sup>[3]</sup>

“Sipas kuptimit të tregimit që do të kallëzojmë më poshtë - sado që lexuesve mund t’u duket e çuditshme dhe gjë jo e mirë - del se dashuri mund të ketë edhe në zemrat e fëmijëve që nuk i kanë mbushur pesëmbëdhjetë vjet. Dashuria është një gjë e natyrshme dhe gjendet tek të gjithë njerëzit: tek të vegjlit dhe tek të rriturit, te foshnjat dhe te rinia, tek të moshuarit dhe te pleqtë, tek të varfrit e tek të pasurit, tek të diturit dhe tek të paditurit, tek të mençurit dhe tek të krisurit, tek të njerëzishmit dhe tek të panjerëzishmit.”

Të gjitha huazimet arabe e persiane, që përbëjnë pjesën dërrmuese të tekstit të sipërshtënuar (shumë pak fjalë janë të turqishtes), kanë hyrë si leksema të thjeshta dhe se shumë lehtë janë inkorporuar dhe i janë përshtatur sistemit gramatikor të gjuhës turke, duke marrë prapashtesa fjalëformuese dhe trajtëformuese turke ose duke marrë folje ndihmëse turke për të formuar pastaj folje të përbëra, për shembull, ndajfolja *zirde*, nga fjala persiane *zir* “i poshtëm” dhe mbaresa rasore e vendores së turqishtes *-de* “në” (në gjuhën e sotme turke zëvendësohet me fjalën turke *aşağıda*); fjala *sabisinde*, nga arabishtja *sabi* “fëmijë” dhe elementet turke *-si* (prapashtesë pronësore), *-n* (n-ja përemërore) dhe *-de* (rasa vendore); *zuhur eder*, nga infinitivi arab *zuhur* “paraqitje, të paraqiturit” dhe folja ndihmëse turke *etmek* formohet një folje e përbërë etj.

Sami Frashëri, si filolog i mirëfilltë, në veprën e tij të parë “Taaşşuk-i Tal’at...”, të cilën po e trajtojmë këtu, përveç që del si njohës i shkëlqyeshëm i leksikut arab e persian, paraqitet edhe si njohës shumë i mirë edhe i leksikut të turqishtes, sepse këtu

[3] Sami Frashëri, Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat, Ankara, 1979, f. 8

gjejmë fjali të tëra ku autori përdor vetëm fjalë turke, për shembull:

“Ragibe Hanım büründükten sonra ikisi el ele tutuşup merdivenin alt başına kadar inerler...”<sup>[4]</sup> / “Pasi u përgatit Ragibja për të dalë, u kapën dorë për dore dhe zbritën gjer në fund të shkallëve...”<sup>[5]</sup>

Te huazimet arabe e persiane vlen të theksohet fakti se në veprën “Taaşuk-i Tal’at...” ato i gjejmë shumë herë me cilësitë gramatikore të gjuhëve dhënëse, për shembull: në shumësin e rregullt dhe të parregullt, në gjini femërore dhe mashkullore, në lidhje gjenitive etj.:

*kaariin*<sup>[6]</sup> “lexuesit”: shumësi i rregullt i gjinisë mashkullore i arabishtes (sot zëvendësohet me fjalën turke *okurlar*);

*adat*<sup>[7]</sup> “zakonet”: shumësi i rregullt i gjinisë femërore (sot: *adetler*);

*eşya*: shumësi i parregullt i arabishtes (e gjejmë të përdorur edhe *şeyler*) “gjëra, sende”. Kësi lloj shumësash gjejmë mjaft në veprën që po e trajtojmë: *evlad, eftar, etfal* etj.;

*ma’suka* “e dashura”: emër në gjininë femërore, ashtu siç përdoret në gjuhën arabe;

*ma’suk* “i dashuri”: emër në gjininë mashkullore, si në gjuhën arabe.

Lidhjet gjenitive persiane dhe arabe janë të pashmangshme kur kemi të bëjmë me leksikun turk të ndikuar nga gjuha arabe dhe persiane. Lidhja gjenitive persiane ose arabe ndërtohet prej dy a më shumë njësive gjuhësore (kur është fjala për lidhjen gjenitive vargënore), të cilat zakonisht janë fjalë të natyrës emërore që përshtaten në numër dhe gjini. Njëra prej gjymtyrëve mund të jetë emër, ndërsa tjetra, ajo që shpreh nocionin cilësor (mbiemër), cila zakonisht është në funksionin e rektumit:

*Firak-i ebedi* – sonsuz ayrılık – ndarja e përhershme<sup>[8]</sup>

Siç shihet edhe nga shembujt e poshtëshënuar, lidhja gjenitive bëhet vetëm me fjalë arabe dhe persiane:

[5] Për çdo shembull të marrë në këtë punim është përdorur përkthimi në shqip i bërë nga ana e Mehdi Polisit dhe Ruzhdi Latas, të botuar në Shkup në shtëpinë botuese Logos, më 2002.

[6] Sami Frashëri, vep. e cit. f. 8

*Halk-i alem* – herkes – gjithë bota<sup>[9]</sup>

*Terk-i dar-i fena* – ölümlü dünyayı terk – braktisja e kësaj bote të vdekshme.<sup>[10]</sup>

Në shembullin e fundit kemi tri njësi gjuhësore të njëpasnjëshme të lidhura me lidhjen gjenitive persiane në mënyrë vargënore.

Këto shprehje sintagmatike, siç thamë më lart, realizohen me fjalë arabe dhe persiane, por është interesant të përmendet se te Samiu, ndoshta edhe për shkak të lirisë së të shkruarit, haset edhe në situata kur njëra prej gjymtyrëve, në rastin konkret rektumi i lidhjes gjenitive persiane, nuk është as fjalë arabe, as persiane, por fjalë burimore turke ose fjalë europiane:

*taraf-i diğer*<sup>[11]</sup> - öbür taraf - ana tjetër,

*iade-i vizite* - ziyaretin iadesi – kthimi i vizitës.

Nga huazimet arabe përdoren zakonisht masdarët, participët, dhe të gjitha llojet e fjalëve emërore.

*tebeddül*<sup>[12]</sup> - *değişiklik* - ndërrimi (masdari i foljes të llojit të pestë: *لَدَبْر - لَدَبْت - لَدَبْر*)

*kâtip*<sup>[13]</sup> - *yazıcı, sekreter, yazman* - shkrimtar (particip aktiv i foljes të llojit të parë: *بِتَاگ - بَتَاگ*) *merkum*<sup>[14]</sup> - *anılan kimse* - i përmendur (particip pasiv i foljes të llojit të parë: *مَوْقِر - مَوْقِر*)

Përdorimi i këtyre është shtuar edhe më shumë për shkak të kombinimeve me foljet ndihmëse turke *olmak, etmek, eylemek*:

*tekasul etme* - gevşek davranma<sup>[15]</sup> (hezitoh), *ihsan eyle* - bağışla<sup>[16]</sup> (dhuroj, ndihmoj);

*hamd olsun* - şükürler olsun<sup>[17]</sup> (falenderim).

Në këtë kontekst, duhet theksuar edhe përdorimi i mensubateve, përkatësisht ndajfoljeve, të cilat e përcaktojnë gjendjen dhe veprimin e subjektit, që në gjuhën e sotme do të ishin shprehur me anë të ndajfoljeve të burimit turk, foljeve infinite, ose ndonjë element tjetër gramatikor:

“...biçare kadını meyu’sen kovardı” - umudunu kırarak<sup>[18]</sup> (duke lënë pa shpresë);

“Cevabını serian bekliyorum.” - pek çabuk<sup>[19]</sup> (shpejt, së shpejti).

Është me interes të veçantë të theksohet se autori në këtë vepër përdor edhe mjaft parafjalë arabe dhe persiane (turqishtja nuk ka parafjalë), si:

*an kasd* (por edhe *kastile*), *an karib*, *fi’l vaki*, *bila ihtiyar*, *ilelebed*,

*bi haber, bi'l cümle.*

Autori nuk ka mundur t'i ikë përdorimit të arabizmave dhe persizmave, sidomos në disa fusha të caktuara, siç është terminologjia islame:

“Ben gelin değilim *el-hamdü-li'llah* kızıım, kızıım ve kız öleceğim.”<sup>[20]</sup>

“Unë nuk jam nuse, unë jam ende vajzë, jam vajzë dhe vajzë do të vdes.”

“Eyvah, hem de bizim için şimdiden sonra bir dakika yaşamak *haramdır...*”<sup>[21]</sup>

“Që nga ky çast, sikur edhe një minutë, është mëkat të jetojmë më...”

“*mehden lahde...*”<sup>[22]</sup> dhe “*el murasele nisful muvasele*”<sup>[23]</sup> janë dy shembuj ku shihet ndikimi i gjuhës dhe i kulturës arabe. Nuk ka mundur t'u ikë edhe shumë fjalëve të tjera të cilat kishin fituar të drejtën qytetare, siç janë: *sokak-rrugë*, *namus* - nder, *dükkan* - dyqan etj. Shumica e këtyre shprehjeve janë rezultat i faktit që disa huazime të huaja të cilat hyjnë në shpirtin e një gjuhe dhe përdoren për shumë kohë, nuk mund të hiqen lehtë nga përdorimi; kështu që janë të ruajtura edhe në gjuhën e sotme standarde turke. Të tilla janë edhe disa fjalë persiane, me kombinim e të cilave formohen fjalë të reja: “-ane”, “-pare”, “-hane”, “-zade”, “-istan”, “-name”, “-mend”. Këto pasfjalë persiane janë kombinuar me fjalë arabe dhe formojnë zakonisht emra të përgjithshëm: *şekerpare*, *kütüphane*, *paşazade*, *şehadetname*, etj.... Më poshtë po përmendim edhe disa fjalë të kësaj natyre që sot përdoren shumë rrallë ose aspak në gjuhën turke:

*varak-pare*<sup>[24]</sup> - kağıt parçası (letër)

*hayal-hane*<sup>[25]</sup> - (ndërmend)

*pür-raşe*<sup>[26]</sup> - titreyişlerle dolu (plotë dridhje)

*haramzade*<sup>[27]</sup> - piç (fëmijë jashtë martese)

*mezaristan* - mezarlık (varreza)

*musibetname*<sup>[28]</sup> - yıkım kitabı (libri i fatkeqësisë)

*meecnunane*<sup>[29]</sup> - deli gibi (si i çmendur).

Në veprën “*Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat*” vërehet mjaft qartë edhe

përdorimi i fjalëve sinonimike, si *zaman*, *vakit*, *an* “kohë, moment”. Samiu edhe në këtë çështje është shumë i suksesshëm, sado që prej tyre më së shumti preferon fjalën *vakit*, madje edhe atëherë kur për shembull fjala *zaman* ose *an* është më e afërt me kontekstin. Për shembull:

“Ne *vakit* gideceğiz?”<sup>[30]</sup> mund të përdoret (ndoshta do të jetë më drejtë): Ne *zaman* gideceğiz?

“Kadın o *vakit* yüzünü cevana çevirip öyle dalmış olduğu...”<sup>[31]</sup> / [Kadın o *anda* yüzünü cevana çevirip öyle dalmış olduğu...]

“Öyle olduğu *vakitte* baba, ana evlatlarına nasıl...”<sup>[32]</sup> / [Öyle olunca baba, ana evlatlarına nasıl...]

“Ne *vakit*, ufaktım da mektebe giderdim, ders okurdum; ne güzel vakitler!”<sup>[33]</sup> / [Ne zamanlar, ufaktım da mektebe giderdim, ders okurdum; ne güzel vakitler!]

Sinonimia, siç dihet, është mjet i fuqishëm, sidomos në letërsinë artistike, për ta bërë më të gjallë gjuhën, për të saktësuar më tej mendimin, për t’i tipizuar më mirë personazhet, për ta pasuruar leksikun dhe për t’i ikur përdorimit të tepruar të së njëjtës fjalë. Pra, edhe në këtë kontekst është me rëndësi të theksohet leksiku i larmishëm i Samiut i cili ekspozohet gati në çdo paragraf të këtij romani: “*birader*” në një vend, ndërsa “*kardeş*” në vend tjetër.

“Bazan setre, bazan bir kısa mor ceket, bir pantolon giyiyor;...”<sup>[34]</sup>

“Bütün o akşam, o gece bu hulya ile meşgul oldu.”<sup>[35]</sup>

Në këtë vepër, në raste të këtilla është zgjedhur edhe sinonimi jo edhe aq i përshtatshëm, por jo vetëm te fjalët e huazuara, por edhe te fjalët burimore turke:

“... yolda tesadüf ettiği *bildikleri* bunun halinden...”<sup>[36]</sup> / [...yoksa tesadüf ettiği *tanudıkları* bunun halinden...]

Përveç fjalëve emërore kemi sinonime edhe te pjesë të tjera të ligjëratës, për shembull foljet të tipit “söylemek”, “buyurmak”, “demek”, “anlatmak”, “ifade etmek”, të cilat gjithashtu, herë-herë janë përdorur në vend të njëra-tjetrës:

“Ne buyurursun, ne buyurursun?”<sup>[37]</sup> / [Ne diyorsun, ne diyorsun?]

“...sana derdimi ifade edeceğim.”<sup>[38]</sup> / [...sana derdimi anlatacağım]

Përdorimi i fjalës *gûya* në vend të fjalës *sanki* në fjalinë e

poshtëshënuar, mund të jetë një ndikim i shqipes, sepse *güya* ka hyrë në gjuhën shqipe që prej kohësh dhe përdoret në trajtën “gjoja”<sup>[39]</sup> ose “gjoja se”.

“Ben *güya* bu kız *evelden görmüşüm*”<sup>[40]</sup> / [Ben *sanki* bu kız *evelden görmüşüm*] = “Unë *gjoja se* e kam parë që më parë këtë vajzë”-“Unë *sikur* e kam parë që më parë këtë vajzë.”

Në veprën “*Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat*” Samiu përdor edhe fjalë europiane, sidomos frënge. Përdorimi i fjalëve të huazuara nga frëngjishtja mendoj se është bërë për dy arsye kryesore: e para, sepse ishte koha kur turqit kishin filluar të orientohen nga Europa dhe, e dyta, sepse autori ishte njohës i mirë i gjuhëve europiane. Mund të përmendim disa prej tyre:

“setre”<sup>[41]</sup>, “familya”<sup>[42]</sup>, “perüke”<sup>[43]</sup>, “modist”, “madmazel”<sup>[44]</sup>, “makina”<sup>[45]</sup>.

## II- ANALIZA MORFOLOGJIKE

Është me rëndësi të theksohet këtu se edhe pse kemi gjetur disa, të themi, gabime morfologjike të cilat do t’i shënojmë më poshtë, nuk mund ta mohojmë njohurinë e gjerë dhe aftësinë e autorit për të përdorur në një mënyrë shumë të drejtë të gjitha elementet morfologjike-gramatikore të gjuhës turke, duke filluar nga struktura morfologjike e fjalës deri te kuptimi leksikor kategorial dhe veçoritë gramatikore të saj.

### Përdorimi i prapashtesave fjalëformuese dhe trajtëformuese

Gjuha turke është gjuhë prapashtesore, prandaj ato luajnë një rol të madh në gjuhën turke. Nëse pajtohemi me fjalët e turkologut të mirënjohur Jean Deny “Të mësosh turqisht, do të thotë të mësosh prapashtesat”, ne, në bazë të analizës së veprës “*Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat*”, lirisht mund të themi se Sami Frashëri e kishte njohur shumë mirë strukturën e fjalës turke. Këtë mund ta ilustrujmë edhe me disa shembuj ku theksohet mënyra e drejtë e përdorimit

<sup>[39]</sup> Tahir Dizdari, Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe, Tiranë, 2005

të prapashtesave turke, qoftë e prapashtesave fjalëformuese, qoftë e prapashtesave trajtëformuese, si edhe lidhshmërinë apo raportet midis këtyre dy llojeve të prapashtesave. Shumë prapashtesa, disa prej të cilave janë specifike për gjuhën e sotme turke, të cilat kanë zënë vendin e fjalëve apo prapashtesave të huaja, Samiu i ka përdorur që atëherë për derivacionin e emrave dhe të mbiemrave. Të tilla janë prapashtesat *-lik*, *-siz*, *-li*, *-ci*, *-leyin*, *-mece*, *-ca*, *-icik*, *-kin*, *-gin*, *-ç*, *-im*<sup>[46]</sup>, të cilat hasen shumë shpesh në ndërtimin e fjalëve: *dal+gin+lık*, *sabır+sız*, *akıl+lı*, *tütün+cü*, *sabah+leyin*, *çek+mece*, *dünya+lar+ca*, *az+ıcık*, *şaş+kın*, *kıskan+ç*, *öl+üm*.

Sa i përket prapashtesave joburimore turke, autori nuk ngurron t'i përdorë as prapashtesat arabe dhe persiane, p.sh., prapashtesa persiane *bi-*, e cila shpreh mohimin: *bi-haber*<sup>[47]</sup>, por edhe *habersiz* "i painformuar", *bi-ilim*, por edhe *ilimsiz* "i padije" etj.

Prapashtesa *"-ç"*, e cila i ka edhe katër variante të tjera (*-inç*, *-inç*, *-unç* dhe *-ünç*) shërben për të formuar emra dhe mbiemra, sidomos nga tema e foljeve vetvetore dhe disa temave foljore me *-n*, p.sh.: *sevirmek* (gëzohem), *seviniç* (gëzim) ose *korkmak* (frikohem), *korkunç* (i tmerrshëm)<sup>[48]</sup>.

Kjo prapashtesë shpeshherë është përdorur në vend të prapashtesës *-lik*: Fjala e formuar me këtë prapashtesë nga tema e foljes *kıskanmak* (xhelozoj), do të jetë një mbiemër *kıskanç* (xheloz). Ndërsa në disa vende autori e përdor si një emër abstrakt me kuptimin "xhelozia", që do të duhej të ishte ndërtuar me anë të prapashtesës *-lik*: *kıskanç +lık*<sup>[49]</sup>. E kemi vërejtur këtë rast edhe te mbiemri "*korkunç*"<sup>[50]</sup>, kur është përdorur si emër i cili do të duhej të ishte formuar me anë të një prapashtese tjetër fjalëformuese *-i*, (*-i*, *-o*, *-ü*): *kork + u*.

Të theksojmë edhe rastet kur autori përdor më shumë se një prapashtesë për të formuar një fjalë, për shembull: *dol+an+dır+ıcı+lık+la*<sup>[51]</sup>. Edhe këtu vërehet qartë njohja e sistemit prapashtesor

[46] Të gjitha prapashtesat e lartpërmendura i nënshtrohen harmonisë së vokalëve, përveç prapashtesës *-leyin* e cila ka vetëm një variant vokalik.

[47] Sami Frashëri, vep. e cit. f. 56

[48] Mehdi Polisi, Gramatika e gjuhës turke, Prishtinë, 2002. f. 122

[49] Sami Frashëri, vep. e cit., f. 31, 52,

të turqishtes si edhe njohja e kuptimeve të këtyre prapashtesave, nga ana e autorit.

E shoh të udhës që në këtë rast të ndalem paksa te prapashtesa e turqishtes *-ki*. Këtë prapashtesë e gjejmë të përdorur mjaft dendur në veprën e Sami Frashërit “*Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat*”. Nga përvoja ime që kam për gjuhën turke, e di që kjo prapashtesë turke u bashkëngjitet emrave dhe përemrave në rasën e vendores (*evdeki, fakultedeki, bendeki*) dhe në rasën e gjinore (*benimki, onunki*) dhe në veprën që po e trajtojmë këtu, vërtet në pjesën dërrmuese të tekstit përdoret sipas rregullave të parapara. Por janë shumë pak fjali ku ajo është përdorur edhe pas emrave në rasën e dhanores, gjë që haset rrallë në të folurin turk dhe fenomen shembulli i të cilit nuk është dhënë në asnjë libër të gramatikës turke.

Në fjalinë “Rifat Bey ileki muhabbetimizin aşk olduğunu hala inanmak istemem.”<sup>[52]</sup> / [Rifat Bey ile olan muhabbetimizin aşk olduğunu hala inanmak istemem.] / “S’ e besoja dot ende që ajo që ndieja për Rifatin ishte dashuri.”

Në fjalinë e poshtëshënuar, kuptimi dhe funksioni i këtij përemri duhet shprehur me participin e foljes “*olmak*” (*olan*), ashtu siç duhet edhe te fjalia vijuese:

“Evet, bu muhabbet, eski zevcemeki muhabbetin aynıdır.”<sup>[53]</sup>  
Pra, *zevcemeki* është përdorur gabimisht, fjalia duhet të jetë: [Evet, bu muhabbet, eski zevceme olan muhabbetin aynıdır] / “Po, kjo dashuri është e njëjta sikur ajo që e ndieja ndaj gruas sime të parë.”

Në fjalinë “Fitnat Hanım’ın Talat Bey’eki muhabbetinden daha ziyade değildi”<sup>[54]</sup>, fjala *Tal’at Bey’eki* duhet të jetë ...*Tal’at Bey’e olan*....

Prapashtesat trajtëformuese pra shërbejnë për të bërë të mundshëm eptimin e fjalëve (lakimin dhe zgjedhimin). Autori bën lakimin dhe zgjedhimin mjeshtërisht duke respektuar sistemin gramatikor të turqishtes.

Nuk e shoh të arsyeshme të zgjatëm më tepër në përdorimin e drejtë të mbaresave dhe prapashtesave përgjithësisht. Në vazhdim të punimit do ta përqendroj vëmendjen time në disa pika morfologjike që mendoj se meritojnë të diskutohen.

Në fjalinë “Kamile bakarsın ki...”<sup>[55]</sup>, fjala “*Kamile*”, meqë është në funksionin e kundrinës së zhdrejtë, duhet të marrë rasën e dhanores (-e): [Kamile+ye bakarsın ki...] Autori e ka përdorur në rasën emërore gabimisht.

Fjalja *Bir gün tenha odamdan* oturmuşum<sup>[56]</sup>, duhet të jetë: [Bir gün tenha *odamda* oturmuşum], domethënë emri *odamdan*, që është në rasën rrjedhore, duhet të jetë në rasën vendore *odamda*, sepse folja *oturmak* shpreh veprimin që ndodh në një vend, kurse rasi e rrjedhore (-den) shpreh zakonisht lëvizjen, rrjedhën, ndarjen a largimin nga një pikë e caktuar<sup>[57]</sup>.

Në fjalinë: “Elmas gibi bir vücud içinde taş gibi bir yüreğin bulunmasını kim inanabilirdi?”<sup>[58]</sup>, fjala *bulunmasını* duhet të jetë në rasën dhanore *bulunmasın+a*, e jo siç është aty në rasën kallëzore, sepse folja, e cila vjen pas saj (*inanabilirdi*), është ndër foljet që kërkon rasën dhanore.

Përemri *beni* në fjalinë “...yoksa beni sorarsan...”<sup>[59]</sup>, për shkak të foljes *sormak* (këtu *sorarsan*) duhet të jetë në rasën dhanore, e jo në rasën kallëzore (*beni*). Meqë këtë gabim e hasim në disa vende, supozojmë se këtu kemi të bëjmë me ndikimin e gjuhës shqipe, sepse në gjuhën shqipe vërtet është në rasën kallëzore.

Në fjalinë “*Ah, insan dünyadan ve dünyada en ziyade sevdiği şeyden ümidini kesmek ne müşkil şey!*”<sup>[60]</sup>, fjala *insan* duhet të jetë në rasën gjinore: *insan-in*, sepse kryefjala e sipjesores me *-dik* (sevdiği) qëndron në rasën gjinore. Pra, nëse kryefjala e emrave prejfoljorë me *-me* dhe të sipjesorëve shprehet me përemra vetorë ose me emra, atëherë këta, si kryefjalë të tyre, duhet të vijnë doemos në rasën gjinore.<sup>[61]</sup> Po ky shpjegim vlen edhe për togfjalëshin *kızın babası* në fjalinë “*Bu kızın babası kim olduğunu kimse bilmezdi.*”<sup>[62]</sup> Edhe togfjalëshi i lartshënuar, pra duhet të jetë në rasën gjinore [*kızın babasının*], domethënë për shkak të sipjesores *olduğunu*: [Bu kızın babasının kim olduğunu kimse bilmezdi.].

Megjithatë, mund të jenë këto disa gabime, do të thosha të rastit, sepse në të shumtën e rasteve këto i përdor në mënyrë të drejtë:

“Talat’ın bu gelmemesini merak eder.”<sup>[63]</sup>

“Ah, bilse benim bu halde bulunduğumu, benim böyle ağladığımı...”<sup>[64]</sup>

[57] Mehdi Polisi, vep e cit f.84

[58] Sami Frashëri, vep e cit. f. 96

[61] Mehdi Polisi, vep e cit., f. 83

[62] Sami Frashëri vep. e cit., f. 34

## Përdorimi i përemrave

Në veprën "*Taaşşuk-i Talat ve Fitnat*" kemi hasur të gjitha llojet e përemrave: vetorë (*ben, sen, biz* etj.), vetvetor (*kendi*), dëftorë (*bu şu, o*), pyetës (*ne, nasil, niçin* etj.), të papërcaktuar apo të pakufishëm (*bazi, diğەر, öteki* etj.) dhe, kur analizojmë përdorimin e tyre, duke i krahasuar me përdorimin e tyre në gjuhën e sotme turke, mund të them me bindje të thellë se autori, Sami Frashëri i ka përdorur me aq përpikëri sa që edhe sot, pas njëqind e sa vitesh, nuk mund t' u bëhet ndonjë vërejtje serioze. I përdor në mënyrë të drejtë në të gjitha rasiat dhe në kombinim me fjalë të tjera. Ja disa shembuj:

"... *benden* umidi kesin artık!"<sup>[65]</sup> / "...hiqma fillin mua"

"...*biz senin* iyiliğın için..." / "për të mirën tënde..."

"Biz *seni* zorla verir miyiz?" / "S' do të të japim me zor"

"...*ikimiz* birden *kendilerimizi* telef edelim!"<sup>[66]</sup> / "të vritemi së bashku"

"Aman, bu birkaç gün *benden* ayrılma."<sup>[67]</sup> / "Aman, këto ditë mos u ndaj prej meje"

"*Sen* ise yalnız *kendini* düşünürsün."<sup>[68]</sup> / "ndërsa ti mendon vetëm për veten"

"Belki bugün *sana* ilelebed..."<sup>[69]</sup> / "ndoshta sot, për herë të fundit po të..."

"Yazık hem *kendisine*, hem evine, hem *size!*"<sup>[70]</sup> / "Turp për të, për shtëpinë, por edhe për ju"

"Canım, bu *sizin* efendi *niçin* evlenmiyor?"<sup>[71]</sup> / "Xhanëm, ky zotëria juaj pse nuk martohet?"

Megjithatë, ka raste kur ndonjëherë përemrat e papërcaktuar i përdor në vend të mbiemrave, për shembull te fjalja "*Babam anam genç evlenmişlerse de birçok zaman cenab-i Hak evlat vermedi.*"<sup>[72]</sup>. Në vend *birçok zaman*, mendoj se më drejt do të ishte ... *uzun zaman* ...

Lidhur me përemrat mund të konstatoj se përemrin vetor të vetës së tretë njëjës Samiu e përdor në dy trajta: në trajtën e vjetër "ol" dhe në trajtën që përdoret sot "o" (ai).

## Përdorimi i mbiemrave

Për të pasur një ide më të qartë se sa njohës i mirë i turqishtes ka qenë Sami Frashëri, ne këtu në radhë të parë duhet të bëjmë një shpjegim të sistemit mbiemëror të saj. Mbiemrat në gjuhën turke kanë këto karakteristika: janë fjalë të pandryshueshme, domethënë nuk marrin mbaresat e shumësit, nuk marrin mbaresat rasore dhe gjithnjë qëndrojnë përpara emrit. Ndërkaq mbiemri në gjuhën shqipe nuk i ka këto karakteristika. Me këtë dua të them se Sami Frashëri, gjuha amtare e të cilit ishte shqipja, me gjithë dallimet e ndjeshme të këtyre dy gjuhëve, edhe në këtë pikë është mjaft i suksesshëm. Mbiemrat, qofshin cilësorë, qofshin përcaktorë, ai i përdor në mënyrë të rregullt, pra sipas rregullave gramatikore të turqishtes. Kjo që u tha këtu, mund të shihet nga shembujt e poshtëshënuar:

“Akılsız, ilimsiz, hilmsiz, faziletsiz, sabırsız, rahimsiz, hayasız adam bulunur, lakin aşksız adam bulunmaz.”<sup>[73]</sup> Pra të gjitha fjalët e ndërтуara me prapashtesën *-siz* janë mbiemra që karakterizojnë emrin *adam*.

“Saliha Hanim okur-yazar bir kadın olmakla...”<sup>[74]</sup> Leksema *okur-yazar* cilëson emrin *kadın*.

Samiu edhe shkallën krahasore të tipit *daha iyi; en güzel* e përdor drejt. Shkallën sipërore e përdor në mënyra të ndryshme, natyrisht sipas natyrës së turqishtes, ashtu siç përdoren edhe në gjuhën e sotme turke: me përsëritjen e mbiemrit (*güzel güzel kızlar*), me përsëritjen e rrokjes së parë të mbiemrit përkatës dhe me ndërhyrjen e bashkëtingëlloreve *m, p, r, s: bembeyaz*<sup>[75]</sup>, *büsbütün*<sup>[76]</sup>, *simsiyah* etj.; me vendosjen e ndajfoljeve të sasisë me kuptimin “shumë, tepër, mjaft, tej mase” para mbiemrave, si: *çok güzel kız, fevkalade zeki, gayet iyi* etj.

Do theksuar këtu se fjalën “*türlü*” të shoqëruar me numërorin “*bir*”, por edhe me përcaktues të tjerë, e shohim të përdorur në vend të fjalëve të tjera. Për shembull, te fjalia “*Kanı bir türlü harekete geldi ki...*”<sup>[77]</sup> mendoj se do të ishte më mirë të përdoret: [Kanı öyle bir harekte geldi ki...]

Ose te fjalia “*Nihayet Fitnat Hanım o günü bu türlü mülahaza ile akşam eder*”<sup>[78]</sup> do të duhej të përdorej: [Nihayet Fitnat Hanım o

günü böyle bir mülhaza ile akşam eder.]

Ose te fjalia “*Bu türlü pek kolay öğrenebilirsiniz.*”<sup>[79]</sup> do të duhej: [Bu şekilde pek kolay öğrenebilirsiniz.]

Edhe fjalia “*Hanım ne türlü kız olacak?*”<sup>[80]</sup> mendoj se më drejt do të ishte: [Hanım nasıl bir kız olacak?]

Më lart pamë se fjala *türlü* do të duhej të zëvendësohej me dëftorët *böyle, öyle*, por kjo nuk nënkupton se autori nuk i përdor këto fjalë, përkundrazi, p.sh., shih fjalinë e poshtëshënuar:

“...böyle bir talih her vakit önüne gelmez.”<sup>[81]</sup> / “... nuk të vjen shpesh një fat i tillë.”

### Përdorimi i foljeve

Sa i përket zgjedhimit, kategorisë së numrit, vetës dhe të diatezës, pra pjesës morfologjike, mund të themi se Samiu nuk ka bërë, pothuaj, asnjë gabim. Një karakteristikë tjetër e foljeve në veprën “*Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat*” është se ato, ashtu si në gjuhën turke, përgjithësisht, janë fjalë turke, ose fjalë të huazuara, por që prapashtesat derivative dhe eptimore i marrin vetëm turke. Domethënë se në gjuhën e sotme turke, e as në gjuhën e atëhershme, nuk ka depërtuar asnjë prapashtesë foljore e huaj. Këtij parimi i ishte përmbajtur saktësisht edhe Sami Frashëri.

Është me interes të thuhet menjëherë se Samiu, ndonëse i ri për nga mosha kur e shkroi veprën, nga njëra anë, e gjuhën shqipe e kishte gjuhë amtare, nga ana tjetër, megjithatë përdor në mënyrë mjaft të rregullt tërë sistemin foljor të turqishtes, pa ndonjë ndryshim të madh nga ai i turqishtes së sotme. Kjo tregon nivelin dhe përgatitjen e tij filologjike përgjithësisht dhe të gjuhës turke në veçanti. Ai, në veprën “*Taaşşuk-i Tal’at ve Fitnat*” vë në qarkullim kohët e thjeshta të foljeve: *gidiyor, gelir, gider*<sup>[82]</sup>; *gitti, geldi; gitmiş, soracak, olacak*; kohët e përbëra të foljeve: *oturmuştu, gelecekti; verdiymiş, sorduydu* (ose *sordu idi*); pastaj format e ndryshme të tyre, posibilitivin: *gelebiliyor, sorabilecek*; impositivin: *gelemem, soramaz, veremeyecek*; formën mohuese: *görmüyor, vermedi* etj. Në

[82] Të gjithë shembujt i kemi nxjerrë nga vepra e përmendur, por i kemi lënë pa shënime për të mos e ngarkuar tekstin

mënyrë të rregullt i ka përdorur edhe mënyrat foljore: kushtoren me prapashtesën *-se/-sa*: *gelse, olsa*; dëshiroren: *geleyim, soralım*; të detyrueshmërisë: *okumalı, yazmalı*; urdhëroren: *gel, okuyun* etj.

Formimin dhe përdorimin e diatezave (veprore, pësore, vetvetore, reciproke dhe shkakore), që kanë shumë rëndësi në gjuhën turke, i ka përdorur me vend. Domethënë, ashtu si prapashtesat emërore, edhe këto të diatezave, i ka përdorur në mënyrë profesionale, pa ndonjë ngatërrim ose prishje të kuptimit të fjalëve:

*güçendirmeğe*<sup>[83]</sup> (ofendoj) = *gücenmek*, *gücen* + *dir* + *mek*,

*çıkartırım*<sup>[84]</sup> (nxjerr) = *çıkmaq*, *çık* + *ar* + *mak*

*dayatılmıŝ*<sup>[85]</sup> (e mbështetur) = *dayamak*, *daya* + *t* + *mak*, *daya* + *t* + *ıl* + *mak*

*birleŝtirmek*<sup>[86]</sup> (bashkoj) = *birlemek*, *birle* + *ŝ* + *mek*, *birle* + *ŝ* + *tir* + *mek*.

Në shembujt e sipërm shihet përdorimi i diatezës shkakore e cila ndërtohet me zgjerimin e rrënjës së foljes me prapashtesat<sup>[87]</sup>: *-dir, -dır, -dur, -dür/-tir, -tir, -tur, -tür; -ir, -ir, -ur, -ür; -t; -it*, dhe *-er, -ar*. Në shembullin e tretë brenda fjalës shihet prapashtesa e diatezës shkakore *-t*, pas të së cilës pason prapashtesa e diatezës pësore e cila, përveç variantit me *-il*, ndërtohet edhe me prapashtesat: *-n, -in, -nil*. Kemi marrë edhe një shembull ku brenda fjalës gjinden dy prapashtesa diatezore, njëra prej të cilave është prapashtesa e diatezës reciproke, ndërsa tjetra prapashtesa e diatezës shkakore (shembulli i fundit). Mbaresat e nënvizuara janë mbaresat trajtëformuese (rasore, kohore, vetore) të cilat, gjithashtu, kanë vendin e tyre në fjalë të tekstit origjinal, vendin që është respektuar me korrektësi.

Më lart thamë se autori i ka përdorur prapashtesat kohore me mjaft pedanteri dhe kjo nuk mund të mohohet. Megjithatë, në shumë pak raste kemi vënë re se ka edhe disa lëshime, sidomos kur përdor ndonjë prapashtesë në vend të prapashtesës tjetër (shumë të afërt për nga kuptimi kohor). Le t'i shohim në vazhdim shembujt e nënvizuar:

[87] Të gjitha prapashtesat i janë nënshtruar harmonisë së vokalëve dhe pozitës së bashkëtingëllorëve në fjalë.

Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Yok kızım yok, sen utanma, baban seni kızdırmak için söyler”<sup>[88]</sup> duhet të jetë: [Yok kızım yok, sen utanma, baban seni kızdırmak için söylüyor]

Koha e tashme me prapashtesën *-ir/-er* në gjuhën turke njihet me termin “*geniş zaman*”. Shpreh veprime të zakonshme, të përsëritshme, veprime që nuk janë të lidhura me një kohë të caktuar. Prandaj në fjalinë e dhënë më lart duhet të jetë me prapashtesën e kohës së tashme, me *-iyor*, e cila tregon ngjarje të ndodhura në momentin e caktuar në kohën e tashme, veprimi ndodh në momentin kur flitet.

Në fjalinë: “E şimdi evleniyorsan o eski saadetin avdet edecektir”<sup>[89]</sup>, fjala e nënvizuar mendoj se duhet të jetë: [E şimdi evlenirsen o eski saadetin avdet edecektir]

Fjalja e poshtëshënuar është fjali e përbërë, veprimi i pjesës së parë të fjalisë është shprehur me folje në kohën e shkuar me një emër sifoljor, ndërsa veprimi i pjesës së dytë të fjalisë vazhdon në kohën e tashme me *-ir*, edhe pse është më e përshtatshme të jetë e shprehur me formën e tregimit të së njëjtës kohë (*-irdi*):

“Babam anam okuyup yazdığımı gördükleri gibi o kadar severler ki tarif olunmaz.”<sup>[90]</sup>

[Babam anam okuyup yazdığımı gördükleri gibi o kadar severlerdi ki tarif olunmaz.]

Koha e shkuar e papërcaktuar shpreh modalitetin e supozimit: “si duket”, “më duket”, “kinse, gjoja se”, përdoret në tregime të ndryshme, në përralla etj., shpreh një veprim të papërcaktuar dhe, po ashtu, një veprim në të cilin folësi nuk është pjesëmarrës a dëshmitar i veprimit të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Prandaj, meqë kryesi i veprimit është vetë folësi, në fjalinë e poshtëshënuar folja *bulmuşum* duhet të jetë *buldum*:

“Gel seni evlendirelim, sana dür danesi gibi bir kız bulmuşum.”<sup>[91]</sup>

[Gel seni evlendirelim, sana dür danesi gibi bir kız buldum.]

Në fjalinë: “Lakin, Rıfat Bey’in evine geldim, çünkü Kamile Hanım, oğlunun içgüveysi girmesine razı olmuştuz ve hatta Rıfat Bey’in ricası üzerine anneme geldiği vakitte dahi orasını teklif etmemişmiş”<sup>[92]</sup>, folja “*razı olmuştuz*” është përdorur

[88] Sami Frashëri, vep. e cit., f. 13

drejt", ndërsa folja "teklif etmemişmiş", e cila gjendet në formën e ashtuquajtur "söylenti biçmi" të kohës së shkuar e papërcaktuar, që shpreh veprimin për të cilin folësi nuk është dëshmitar, nuk është përdorur drejt, prandaj duhet të jetë: *teklif etmemişti*.

Edhe në fjalitë e përbëra pa lidhëza haset në probleme të këtij lloji. Në fjalinë: "Araba kapıda bekliyordu; çıkırlar, binerler"<sup>[93]</sup>, foljet e nënvizuara duhet të jenë në format: *çıkıtlar*, *bindiler*, *sepse*, meqë fjalia ka filluar me foljen në kohën e pakryer të së shkuarës me *-iyordu*, duhet të vazhdojë me po të njëjtën kohë, e jo me foljet në kohën e tashme me *-ir*. Pra, veprimet e kësaj fjalie, të shprehura me foljet "çıkımak" dhe "binmek", kanë përfunduar në një çast të caktuar në të shkuarën.

Këto dy folje mund të lidhen edhe me anë të formës së pashtjelluar të tipit *-(y)ip*, e cila përdoret për të lidhur dy veprime të bashkërenditura të kryera nga e njëjta kryefjalë: [Araba kapıda bekliyordu; çıkıp bindiler.]

Kjo formë, si edhe forma të tjera të pashtjelluara<sup>[94]</sup> foljore, përdoret për të shmangur përsëritjen e foljeve, pra për ekonomizimin e gjuhës, gjë që në gjuhën turke është shumë e dendur. Autori përdor edhe fjali të tilla, madje shumë dendur, që, pa dyshim, tregon njohjen e këtyre formave.

### Përdorimi i lidhëzave

Lidhëzat, edhe në gjuhën turke lidhin gjymtyrë fjalie ose dy fjali dhe shprehin marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre. Në veprën "Taaşşuk-i Tal'at..." përdoren gati të gjitha lidhëzat e mundshme që përdoren edhe në gjuhën e sotme turke. Janë përdorur lidhëzat burimore turke, por edhe, madje më shumë, ato të burimit arab dhe persian. Janë përdorur të gjitha llojet e lidhëzave: të parme, të përbëra, të përsëritura etj. Në këtë pjesë të punimit tim do të shënoj disa fjali të nxjerra nga vepra që po e trajtojmë, në të cilat përdoren lidhëza të ndryshme:

[94] Forma të pashtjelluara turke janë: *-(y)ip*, *-(y)e*, *-(y)erek*, *-(y)ince*, *-(y)eli*, *-r...-mez*, *-(y)esizle*, *-meden*, *-cesine*, *-ken*, *-meksizin*. Por edhe disa tipe të sifoljorit me *-dik*.

“...gerek kalem şerikleri, gerek bilcümle bildikleri...” [95]

“Cuma günü de ya sen onun evine, ya [96] o buraya gelecektir” [97]

“O kadar sevdiği karısından ayrıldığına ve onun dahi o kadar hakaretle gönlünü kırdığına müeessif olur, pişman olur.” [98]

Lidhëza *dahi* është trajtë e vjetër dhe në gjuhën e sotme turke në vend të saj përdoret gjithnjë e më tepër varianti *de*. Te Samiu i gjejmë paralelisht të dyja. Lidhëzat “*ile*” dhe “*ve*” janë lidhëza këpujore që përdoren për të lidhur dy fjalë homogjene të fjalisë ose dy a më shumë fjali që kanë të njëjtin funksion. Më dendur përdoret lidhëza e burimit arab “*ve*” (*dhe*).

“Fitnat Hanım dahi Tal’at Bey’i nasıl sevdiğini ve kız kıyafetyyle gördüğü vakitte dahi nasıl müteessir olduğunu ve Tal’at Bey ile evlenmesine nasıl hulyalar kurduğunu gösterdi.” [99] / “Fitneti i tregonte se si e ndiente veten kur e shihte Talatin me rroba të grave, se çfarë mendimesh kishte për martesën me Talatin, se sa e donte atë.”

“Kah nakışa dikkat ve kah işin nasıl ileri varacağını düşünür, ve kah hilesinin meydana çıkmasından korkar” [100] / [Kah nakışa dikkat, kah işin nasıl ileri varacağını düşünür, kah hilesinin meydana çıkmasından korkar] / “Herë e shikonte me vëmendje endjen e herë mendonte si t’ia arrinte qëllimit e herë frikësohej se mos dilte në shesh dredhia.”

“...ne o ve ne de Talat Bey” [101] [...ne o ne de Talat Bey] / “...as ajo e as Tal’at Beu...”

Në dy fjalitë e fundit (turqisht), së bashku me lidhëzat e përsëritura *kah...kah* dhe *ne...ne* është përdorur gabimisht lidhëza *ve* (*dhe*). Mendoj se këtu kemi një ndikim të shqipes. Përveç lidhëzës bashkërenditëse *kah...kah*, të cilën e përmenda më sipër, hasim edhe lidhëza të tjera të huazuara: *velev* (*ki*), *lakin*, *velakin*, *meğer*; nga lidhëzat nënrenditëse kemi: *çünkü*, *zira*, etj:

“...Söz söylemeğe mecalim yok, lakin “Şayet şu efendi Rif’at Beydir.” ...” [102] / “S’kisha fuqi të them asnjë fjalë, por...! Kush e di!

[96] Kjo lidhëz e përsëritur ka hyrë edhe në gjuhën shqipe.

[97] Sami Frashëri, vep e cit., f. 14

A mos ndoshta ky zotëri është Rifat beu?"

Në këtë shembull shihet se lidhëza e burimit persian "*şayet*", që do të thotë "nëse, në qoftë se" është përdorur në vend të ndajfoljes "ndoshta", kuptimi i së cilës, në gjuhën turke, shprehet me fjalën arabe "*belki*". Kjo ndoshta ka ndodhur për shkak të kuptimeve të afërta të këtyre dy fjalëve:

*şayed* = *ola ki, olabilir ki, eğer.* <sup>[103]</sup>  
*bel-ki* = *ihtimal, umulur, olabilir*

Në fjalitë lidhore autori shumë shpesh ka përdorur edhe lidhëzën "*de*", e cila në gjuhën shqipe përkthehet: "dhe, edhe, e". Si pjesëz përdoret edhe për të lidhur fjali lejore:

"Valide hanımı kandırıp da seni evvel emirde iç güveysi girmeye bırakırsa..." <sup>[104]</sup> / "Nëse mund ta bind nënën, që ti të vish dhe të jetosh tek ime më."

Për shkak të kuptimit të kësaj lidhëze, nganjëherë, është përdorur për të lidhur fjali shkakore, në vend që ta përdorë fjalën "*ise*":

"...seni o kadar tahkir eyledi de sen hala onu seviyorsun" <sup>[105]</sup>  
/ [...seni o kadar tahkir eyledi sense hala onu seviyorsun] / "ai të poshtëroi e ti prapë e do"

"Biz sevincimizden çıldıracağız da sen ne diyorsun ki kocaya varamam?" <sup>[106]</sup> / [Biz sevincimizden çıldıracağız sense ne diyorsun ki kocaya varamam?] / "Ne luajtëm mendsh nga gëzimi, e ti thua se nuk do ta marrësh?"

### Përdorimi i parafjalëve

Në gjuhën turke nuk ka parafjalë siç është rasti te gjuha shqipe; këto nocione shprehen me anë të pafjalëve, të cilat mund të grupohen sipas përdorimit të tyre. Pasfjalë të cilat përdoren me rasën e emërores dhe ato janë: *için, ile, kadar, gibi*:

"Fitnat Hanım daima dikiş ve gergef + le meşgul olur..." <sup>[107]</sup>  
/ "Fitnetja gjithmonë është e zënë me qëndisje dhe qëndismë..."

<sup>[103]</sup> Ferit Devellioğlu, Osmanlıca – Türkçe Ansiklopedik Lügat, Ankara, 1970

<sup>[104]</sup> Sami Frashëri, vep e cit. f. 22

Pasfjalët që përdoren me rasën dhanore, janë: *göre, kadar, doğru, karşı, nispeten, nazaran, dair, ait, rağmen* dhe shumë pasfjalë të tjera me prejardhje arabe:

“...bir dereceye kadar...”<sup>[108]</sup> / “...deri dikund...”

Rasa e rrjedhore si grupon pasfjalët: *önce, sonra, beri, dolaylı, başka, itibaren, yana, dışarı, içeri, yukarı, aşağı, ileri, geri.*

“...eve biraz nizam verdikten sonra...”<sup>[109]</sup> / “...pasi që e rregulloi pak shtëpinë...”

“Birkaç aydan sonra sen dünyaya geldin.”<sup>[110]</sup> / “pas disa muajsh linde ti.”

Pasfjala “*sonra*”, e përmendur në fjalinë e S. Frashërit, si edhe të gjitha pasfjalët e tjera të këtij grupi, kërkon që emri që vjen para saj të jetë në rasën rrjedhore, por jo edhe gjymtyra emërore e sintagmës së formuar me njëri nga fjalët që shprehin një periudhë të caktuar kohore (*birkaç ay*). Sipas këtyre rregullave, fjalia e Samiut do të ishte:

[Birkaç ay sonra sen dünyaya geldin.]

Edhe këtu vërehet ndikimi i gjuhës shqipe<sup>[111]</sup>, sepse në disa vende ky lloj i të shprehurit është formuar mirë:

“...ve birkaç ay sonra...”<sup>[112]</sup> / “... pas disa muajve...”

### III- ANALIZA SINTAKSORE

Sipas natyrës aglutinative, në fjalitë burimore turke të gjitha fjalët që kanë karakter cilësor, domethënë fjalët përcaktuese, vijnë para fjalëve të përcaktuara. Për këtë arsye, radhitja e fjalëve në sintaksën turke është mjaft e fiksuar<sup>[113]</sup>: kryefjalë+kallëzues.

Në gjuhën bashkëkohore turke ndërkaq gjithnjë e më tepër hasen fjali në të cilat radhitja e fjalëve nuk është aq e fiksuar. Në shumë raste, pra, kemi kallëzues+kryefjalë. Domethënë edhe pse kryefjala e fjalisë së rregullt në gjuhën turke zakonisht vjen në fillim të fjalisë, ajo mund të lëviz brenda fjalisë, madje mund të vendoset

[111] Mbaresat rasore (pas disa muajsh) e rrjedhore në gjuhën shqipe shërben për të formuar mu këto lloj të shprehive kohore.

[112] Sami Frashëri, vep e cit. f. 34

[113] Jasna Šamić, Prilozi za orijentalnu filologiju, 27/1977, Sarajevo, 1979, f. 120

edhe pas kallëzuesit, por me kusht që kryefjala dhe kallëzuesi të kenë autonominë sintaksore.<sup>[114]</sup>

Për shkak të natyrës aglutinative të turqishtes, kallëzuesi, përkatësisht folja, edhe kur nuk ka ndonjë plotës tjetër, mund të jetë një fjali e thjeshtë e cila do të ketë edhe kryesin e veprimit brenda strukturës së saj: *biliyorum* “unë di”. Vendi i plotësve të tjerë (tümleçler) në fjalitë e rregullta është midis kryefjalës dhe kallëzuesit.

Është rregull i veçantë në sintaksën turke se fjalitë, kallëzuesi i të cilave vjen në fund, quhen fjali jo të rregullta. Radhitja e fjalëve në fjalitë jo të rregullta është më e lirë dhe kjo sidomos në krijime letrare (poezi), gjatë ligjërimit, kur njësitë gjuhësore shpeshherë radhiten në mënyrë të papritur, pra gjatë komunikimit të lirë. Këta tipa të fjalive në gjuhën turke gjithnjë e më tepër hasen te shkrimtarët e brezave më të rinj. Por, edhe pse autori i përket gjeneratës së vjetër, në veprën “*Taaşşuk-i Tal’at Ve Fitnat*” fjalia e tij shpeshherë është e tipit indoeuropian që i jep shprehjes një dinamizëm dhe ritëm të veçantë. Megjithëkëtë, në veprën e tij ballafaqohemi edhe me fjali të tipit burimor turk. Kur kemi parasysh pra dy tipat e fjalive të përmendura në veprën që po e trajtojmë, të konstatojmë dy karakteristika themelore të autorit të saj, Sami Frashërit. E para, të themi se Sami Frashëri, duke njohur mirë jo vetëm gjuhën shqipe, gjuhën amtare të tij, por edhe gjuhët e tjera europiane, ka ditur që në atë kohë të vë në qarkullim me shkathtësi të jashtëzakonshme fjalitë e tipit indoeuropian, pikërisht në kohën kur akoma hamendej për to. E dyta, se Sami Frashëri ishte edhe njohës i shkëlqyer i gjuhës burimore turke. Një gjë të tillë e kemi vënë re gjatë analizës gjuhësore të kësaj vepre. Në vazhdim, për të qenë më konkret, do të jap fjali edhe të njërit, edhe të tjetrit tip.

“- Ah çok hoşnudum oğlumdan!”<sup>[115]</sup> - është një ilustrim i përdorimit të njësive gjuhësore në një mënyrë të lirë. Sipas radhitjes së rregullt të fjalëve, objekti do të vinte para kallëzuesit dhe përcaktorit të tij: Ah, oğlumdan çok hoşnudum! / “Jam shumë e kënaqur me djalin tim!”

[115] Sami Frashëri, vep e cit. f. 4

Këtu shtrohet pyetja e autonomisë sintaktike të klasave të monemave me të cilat vepron sintaksa. Pra, në qoftë se gjatë ndërrimit të vendit të njësisë së fjalisë nuk humb kuptimi i saj dhe nuk ndryshon kuptimi i tërë fjalisë, ajo njësi është autonome dhe mund të lëvizë lirisht sipas dëshirës, apo stilit të shkrimtarit. P.sh.: “Baška hulyalar zihnime gelmeğe başladı”<sup>[116]</sup> / “Në mendimet e mia filluan të vijnë kujtime të tjera.”

Fjalia mund të shprehet në disa mënyra me ndërrimin e vendeve të tyre, sepse njësitë: “*Baška hulyalar*”, “*zihnime*”, “*gelmeğe*”, “*başladı*” janë gramatikisht autonome dhe mund të lëvizin brenda fjalisë:

*Zihnime başka hulyalar gelmeğe başladı.*

*Başka hulyalar zihnime başladı gelmeğe.*

*Zihnime başka hulyalar başladı gelmeğe.*

Kur themi gramatikisht autonome, duam të themi se është e rëndësishme edhe pjesa semantike e këtyre njërive. Sipas rregullave gramatikore të sintaksës turke, fjala më e rëndësishme në fjali qëndron para kallëzuesit. Për këtë arsye, fjalitë e tipit indoeuropian, të cilat formohen me një gjuhë mjaft fleksive, shpeshherë duken të gabueshme:

“Ondan iyi şey dünyada yok”<sup>[117]</sup> [dünyada ondan iyi şey yok] / “S’ka më mirë”

Fjalia e Sami Frashërit është edhe e shkurtër, edhe e gjatë, varësisht nga përshkrimi. Ai që atëherë, siç thamë më lart, përdor fjali edhe të tipit tradicional turk edhe të tipit indoevropian, gjë që është më tipike dhe më interesante për sintaksën e tij.

Sipas modelit burimor turk, në fjalitë e zgjeruara me fjali të varura (nënrenditëse) dhe kryesore (bashkërenditëse), së pari vijnë fjalitë e varura me pjesore dhe sipjesore dhe pastaj fjalia kryesore:

“Biçare ihtiyarlar geçmiş şeyleri hatırlarına getirdikçe mahzun olurlar.”<sup>[118]</sup>

“...onu görmediğim vakitte seni görmekle müteselli olurum.”<sup>[119]</sup>

“Ah felek, bana bu kadar nimet gösterdikten sonra şimdi nasıl mahrum etmek istiyor!...”<sup>[120]</sup>

“...Hacıbaba komşularıyla çok iyi geçinmediğinden ve taraf-ı diğerden Fitnat Hanım’ın kimseye iade-i vizite etmeyeceği belli olduğundan komşulardan hiç kimse Hacıbaba’ya misafir olmaz.”<sup>[121]</sup>

Formimi i këtyre fjalive të varura kohore dhe shkakore gjithashtu tregon edhe përdorimin e drejtë të proparticipëve turke. Sipas modelit turk janë edhe fjalitë e nënrenditura të lidhura me anë të foljes “*demek*”, në format “*diye*” dhe “*derken*”. Folja “*demek*” shërben edhe për të shprehur ligjëratën e drejtë: “Bir baş ağrısına uğradım”, dedi.<sup>[122]</sup> / “Më është kthyer dhembja e kokës”.

Fjalitë e varura, të shprehura me gjerundin “*diye*”, sipas kriterit semantik mund të klasifikohen në fjali dëftore, pyetëse, nxitëse, qëllimore dhe shkakore<sup>[123]</sup>.

“...rüya olmasın diye gözlerini yoklar”<sup>[124]</sup>, është një shembull i përdorimit të gjerundit “*diye*”, ku lidhen dy fjali të nënrenditura dhe fjalia e varur është një fjali shkakore dhe vjen para fjalisë kryesore.

Sa i përket fjalive të tipit indoevropian, sipas të cilëve pjesa e varur vjen pas pjesës kryesore, mund të marrim shembullin e poshtëshënuar, ku kemi një periudhë me fjali të bashkërenditura në mënyrën urdhërore:

“Sözümü kesme, dinle ne söyleyeceğim, dedi.”<sup>[125]</sup>

Fjalia e dytë e kësaj periudhe asidentike është gjithashtu një fjali e përbërë, sepse shpreh një ligjëratë të drejtë të bashkëngjitur foljes “*dedi*”: *dinle ne söyleyeceğim* – “dëgjo ç’po të them”. Sipas mënyrës tradicionale turke, folja e dytë finite do të shndërrohet në folje infinite të cilës i vihet mbaresa rasore e akuzativit “-i”, kurse folja e parë, e cila është në mënyrën urdhërore, do të vinte në fund të fjalisë. Pra, fjalia e varur do të ishte kësisoj: [ne söyleyeceğim-i dinle] ose [dinle ne söyleyeceğim-i].

Kur flasim për fjali të tipit indoeuropian, mund themi se shumë të shpeshta janë fjalitë e lidhura me anë të përemrit lidhor *ki*, i cili i përgjigjet përemrit të gjuhës shqipe *që*, sidomos te fjalitë dëftore ku pjesa kryesore shprehet me ndonjë folje të tipit: “*bakmak*”, “*bilmek*”, “*zannetmek*”, “*anlamak*”, “*söylemek*”, etj.:

“Anlamıştım ki Rifat Bey beni severdi.”<sup>[126]</sup> / “E kuptova se Rifati më do”

“Anam dün akşam söylüyordu ki baba-ana kızlarını, oğullarını

[123] Abdullah Hamiti, Gramatika e gjuhës së sotme turke, Prishtinë, 2001, f.270

[124] Sami Frashëri, vep e cit. f. 48

istedikleri gibi evlendirir..."<sup>[127]</sup> / "Ime emë mbrëmë tha se prindërit, fëmijët e tyre i martojnë si duan..."

Edhe pse përdorimi i këtij përemri është mjaft i zvogëluar pas thjeshtëzimit të turqishtes, ai mbetet të jetë një mjet gramatikor me një semantikë të gjerë i cili haset shpesh në krijime letrare turke. Përemri lidhor *ki* zëvendëson shumë forma gramatikore siç janë foljet infinite dhe pasfjalët; pra e ka funksionin e lidhëzës nënrenditëse e cila i lidh fjalitë të varura nënrenditëse, qofshin ato fjali dëftore, nxitëse, rrjedhimore, qëllimore, shkakore ose kohore:

"İşte altı ay oldu ki görüşemiyoruz."<sup>[128]</sup> / "u bënë gjashtë muaj që nuk u takuam."

"... senin gönderdiğin mektuplar koynumda duruyor ki onlar dahi kana boyasınlar!"<sup>[129]</sup> / "letrat të cilat më ke dërguar, i kam në krah, që edhe ato të skuqen me gjak!"

"... bin defa kurarım ki gideyim, gittiğim gibi cesaret edemem"<sup>[130]</sup> / "... një mijë herë mendoj të shkoj, por kur shkoj nuk kam guxim të..."

Kemi përmendur më herët se ndodh që fjalìa e Samiut, varësisht nga përkrahimi, të jetë edhe e gjatë. Për këtë arsye, përveç përemrit lidhor *ki*, participëve dhe proparticipëve ai ka përdorur mjaft edhe lidhëzat bashkërenditëse si edhe shenjat e pikësimit. Ajo që është tipike për fjalinë e Samiut është fakti se ai nuk i ikën asnjërit prej tipave të fjalive, përkundrazi i përdor dhe i shfrytëzon të gjitha njohuritë gramatikore që i posedon. Në turqishten e sotme, presja (,) nuk është vetëm një mjet i rëndësishëm shprehës dhe stilistik, por është edhe një mjet sintaktik i cili gjendet brenda fjalive të varura dhe të pavarura. Nga përdorimi i presjes shpeshherë varet edhe semantika e shprehjes. Kjo shenjë e pikësimit mund të vijë në vend të lidhëzave nënrenditëse në fjalitë e varura, nga një anë, dhe,

---

[130] Po aty, f. 23. Në këtë shembull vërehet proparticipi turk me -dik e kombinuar me pasfjalën "gibi" (-diği gibi), me të cilin është ndërtuar fjalìa e varur kohore. Ky është një nga proparticipet të cilat mund të shprehen edhe me ndonjë term tjetër ose në ndonjë formë tjetër gramatikore, si për shembull, me një proparticip tjetër me -dik, (-diğinde), me formën e pashtjelluar -ince, ose në ndonjë mënyrë tjetër. Por autori vazhdimisht përdor këtë proparticip, i cili shpreh veprimin e fjalisë së varur që ndodh në të njëjtën kohë si veprimi kryesor. E ka përdorur aq shumë sa që mund të themi se - si çdo përsëritje tjetër e fjalëve edhe kjo - lexuesit i jep një ndjenjë të monotonisë.

nga ana tjetër, në vend të lidhëzave bashkërenditëse, siç janë “ve”, “de” etj. në fjali të pavarura.<sup>[131]</sup> Frashëri përdor shenja të pikësimit edhe aty ku me anë të formave të participeve ose proparticipive mund të shprehet fjalia e varur. Domethënë, me anë të presjeve dhe lidhëzave bashkërenditëse ka formuar më shumë fjali të bashkërenditura se sa ato të nënrenditura.

“Hem de ben size bir kız göstereyim: pek uslu, gayet mükemmel bir kız, pek güzel nakış bilir, hem derse de pek çok sevdası var; sen de ona biraz ders, biraz yazı gösterirsin, olmaz mı?”<sup>[132]</sup> / [Hem de size kendisine biraz ders ve yazı göstereceğin, pek uslu ve gayet mükemmel, pek güzel nakış bilen hem de derse pek çok sevdası olan bir kız göstersem olmaz mı?] / “ Dhe t’ju tregoj një vajzë: është shumë e urtë, shumë e mirë, e bukur e din qëndisjen, por edhe e do shumë edhe mësimin; edhe ti ndihmoji asaj pak në mësim e pak në shkrim, mirë?”

Mund të marrim edhe një shembull ku shihet përdorimi i fjalive të shkurtra të pavarura që e bëjnë gjuhën e tij më dinamike, më energjike dhe më të gjallë, të cilat janë shumë të shpeshta në tregimin e autorit. Paragrafi i kapitullit “*Inkişaf-i Zamir*”<sup>[133]</sup> (Brendia e bisedës):

“Bir cuma günü Rif’at Bey bana gelmişti. Peder de evde bulundu. Rif’at Bey gitti pederimin elini öptü. Peder ne okuduğunu, ne yazdığını sordu, anladı. Onun güzel hareketini, güzel söylemesini pek çok beğendi, tahsin eyledi. Rif’at Bey gittikten sonra, akşam, odaya girdim; baktım ki babam anamla konuşuyorlardı ve bir çocuğu methediyorlardı. Anladım ki Rif’at Bey’i meth ediyorlar, gönlüm tiz tiz vurmağa başladı. Kızardım, sarardım, nihayet oturdum; işitiyorum ki şu mükalemeyi ederler.”

[Bir cuma günü Rif’at Bey bana geldiğinde peder de evde bulundu. Rif’at Bey gidip pederimin elini öptü. Peder ne okuyup yazdığını sordu ve anladı. Onun güzel hareketini ve söylemesini pek çok beğenmekle beraber tahsin eyledi. Rif’at Bey gittikten sonra, akşam odaya girince anamla babamın konuşup bir çocuğu methettiklerini duydum. Rif’at Bey’i methettiklerini anlayınca

[131] Jasna Šamić, Prilozi za orijentalnu filologiju, 27/1977, Sarajevo, 1979, f. 129

[132] Sami Frashëri, vep. e cit., f. 46

gönlüm tiz tiz vurmaya başladı. Kızarıp sarardıktan sonra nihayet oturdum ve şu mükalemeyi ettiklerini işittim.]

“Një të premte, babai gjendej në shtëpi, kur vjen Rifat Beu dhe, pasi hyn, i puthi dorën. Babai e pyeti se ç’kishim lexuar e shkruar. Rifati ia shpjegoi për bukuri. Sjellja e bukur dhe biseda e mirë e Rifatit i lanë mbresa të mira babait. Në mbrëmje, tek po shkoja në dhomë, dëgjoja prindërit duke lavdëruar një djalë. Kur kuptova se ishte fjala për Rifatin, zemra zuri të më rrahë fort. U skuqa, u zbeha dhe më në fund u ula dhe dëgjoja bisedën.”

Në gjuhën e S. Frashërit, në disa raste vërehet ndikimi i gjuhës së tij amtare, si për shembull pjesëza pyetëse “a”, e cila në gjuhën turke mendoj se shprehet me pjesëzën turke “ha” ose me pjesëzën turke “ya”, të cilat, gjithashtu, shprehin përforcimin e pyetjes. Ajo në gjuhën shqipe përkthehet si pjesëz “a”, “ë”...

“olacak a, görmedik bilmedik bir kız alırlar...”<sup>[134]</sup> / [olacak tabii, görmedik bilmedik bir kız alırlar]

“Sana dedim a söz bağlamışlar...”<sup>[135]</sup> / [sana dedim ya söz bağlamışlar...]

Sa i përket përdorimit të saj te shembujt: “Hala inanıyorsun a?”<sup>[136]</sup> dhe “O da seni sever a?”<sup>[137]</sup>, sipas rregullave do të ishte shprehur me anë të pjesëzës pyetëse turke “mi”, e cila qëndron pas fjalës së theksuar:

[Hala mı inanıyorsun?] / [O da seni sever mi?]

Kur flasim për fjalitë pyetëse, është me rëndësi të përmendet që në gjuhën turke fjalitë pyetëse me intonacion kanë hyrë me disa elemente gjuhësore europiane dhe dihet që kjo ka ndodhur pas periudhës në të cilën është shkruar kjo vepër. Ndërkaq, në këtë vepër hasen fjali pyetëse të formuara që në atë kohë në këtë mënyrë ku, edhe këtu, manifestohet ndikimi i gjuhëve indoeuropiane:

Fjalja: “Siz daha gençsiniz bekâr oturmanın sebebi?”<sup>[138]</sup>, mund të jetë në fund me përemrin pyetës: [Siz daha gençsiniz bekâr oturmanın sebebi ne?]

Fjalja: “Zannedersin ki senin o türlü hareketinden o merhumenin ruhu hoşlansın?”<sup>[139]</sup>, mund të jetë: [senin o türlü hareketinden o merhumenin ruhunun hoşlanacağını mı zannedersin?]

Ose te një fjali e përbërë pyetëse ku në një pjesë të saj shihet pjesëza pyetëse, ndërsa tek tjetra jo, siç bëhet në gjuhën shqipe:

“Bilmem ađlamadan, keder etmeden mi, yoksa sođuk aldım?”<sup>[140]</sup> / [Bilmem ađlamadan, keder etmeden mi, yoksa sođuk mu aldım?] / “Nuk di mos nga të qarët, apo nga të ftohtit u sëmura.”

Meqë fjala e theksuar në fjalitë pyetëse është përemri pyetës, vendi i tij është para foljes ose grupit foljor. Domethënë se në të kundërtën fjalia është jo e rregullt (devrik tümce). Ka mjaft fjali të tilla në këtë vepër:

“Biz de düğüne mi gidiyoruz?”<sup>[141]</sup> / [Biz de mi düğüne gidiyoruz?]

“Nakış nasıl öğrenmemiş şimdiye kadar”<sup>[142]</sup> / “Şimdiye kadar nasıl nakış öğrenmemiş?”

Çdo përcaktor në gjuhën turke vendin e ka të fiksuar, pra qëndron para fjalës të cilën e përcakton. Ashtu edhe ndajfolja kohore “*daha*”, e cila vjen para foljes, kur është e shoqëruar me numërorin “*bir*” ose me ndonjë ndajfolje tjetër që shpreh nocione sasiore (*birkaç, birçok*). Nëse në fjali janë prezente njësi të tjera sintaktike që shprehin nocione kohore, sasiore etj., ndajfolja “*daha*” vjen në pozicionin pas tyre. Autori në disa vende nuk e vendos këtë ndajfolje në vendin e duhur, nganjëherë për shkak të stilit të tij të shkruarit, por edhe për shkak të ndikimit të gjuhës së tij amtare:

“Daha birkaç ay geçti.....”<sup>[143]</sup> / [Birkaç ay daha geçti....] / “Kaluan edhe disa muaj...”

“...gördüğü şey daha bir kat güzel görünür”<sup>[144]</sup> / “...gördüğü şey bir kat daha güzel görünür] / “Atë që e pa herën e parë, e pa sërish dhe iu duk edhe më e bukur.”

Në shembullin e fundit, ndajfolja “*daha*” nuk shpreh nuancë kohore, por cilësore, shërben si mjet për realizimin e krahasimit të mbiemrave dhe, si e tillë, qëndron para mbiemrit të cilin e përcakton.

Kam nxjerrë edhe disa shembuj të tjerë ku prishet sintaksa e fjalisë: “...her şey<sup>2</sup> elinden<sup>1</sup> gelir”<sup>[145]</sup>

Kombinimi i fjalës “*el*” në rasën rrjedhore (-den) me foljen gelmek, pra “*elden gelmek*” kërkon që kundrinori të theksohet në mes këtyre dy fjalëve, përndryshe e humb kuptimin: “her şey elinden gelir” / [çdo gjë i shkon nga dora] jo [çdo gjë i shkon për dore]

“... görür ki o<sup>2</sup> bütün<sup>1</sup> hanımlar...”<sup>[146]</sup> / “...ajo pa gjithë ato

zonja...”

Në mes përemrit dëftor dhe njësisë të cilën e përcakton, mund të vijë ndonjë përcaktues tjetër: “*o miskokulu çiçekler*”. Pra, të dy përcaktuesit përcaktojnë të njëjtën gjymtyrë. Ndërsa në rastin kur përemri (në rastin konkret përemri i papërcaktuar “*bütün*”) përcakton togfjalëshin që është përbërë prej përemrit dëftor (*o*) dhe emrit (*hanımlar*), përemri *bütün* nuk mund të vijë në mes; ashtu siç nuk mund të jetë i ndarë asnjë togfjalësh tjetër me ndonjë përcaktues.

“Fitnat yalnız<sup>2</sup> arabada dahi beraber olduğu kız ile<sup>1</sup> kalır...”<sup>[147]</sup> / “Fitneti mbeti vetëm me vajzën që e shoqëroi në karrocë...”

Këtu fjala “*yalnız*”, pa marrë parasysht radhitjen e fjalëve në gjuhën shqipe, duhet të qëndrojë pranë kallëzuesit, sepse me ndërrimin e vendit të saj kjo fjalë humb kuptimin dhe do të duhej të përkthehej: “Fitneti vetëm me vajzën që e shoqëroi në karrocë mbeti...”. Por, nëse vendoset një presje pas kësaj fjale, ajo do ta ruajë kuptimin vet.

“...ister herife çıkışsın, fakat...”<sup>[148]</sup>

Shembulli i tetë është fjalia tipike e S. Frashërit në stilin e fjalisë indoeuropiane, ku folja vjen para infinitivit: “ister çıkışsın”. Përveç kësaj, kjo sintagmë kallëzuesore nuk pranon gjymtyrë tjetër në mes. Kështu që fjalia do të jetë “...herife çıkışmak ister” dhe jo [ister herife çıkışsın] ose [çıkışmak herife ister].

Sa i përket ndërtimit të fjalisë, duhet përmendur edhe tipi i fjalive të gjata.

“Fitnatım, ne halde bulunduğunuzu çabuk yaz; mektubu Şerife Kadın’a ver de bana gönderir, alırım...”<sup>[149]</sup> / “Fitneti im! Më shkruaj sa më parë dhe më trego se në çfarë gjendje je. Letrën le të ma sjellë Sherifja përmes dikujt...”

Vetëm një nga kryefjalët është e përmendur dhe ajo është “Fitnat”, nga e cila kërkohet që të kryejë një veprim, meqë folja *ver* është në mënyrën urdhërore. Nga kuptimi i foljes *göndermek*, nënkuptohet se kryesi i këtij veprimi është gjithashtu *Fitnat*. Problemi qëndron në mënyrën e kësaj foljeje e cila, sipas kontekstit të fjalisë, shihet se duhet të jetë në mënyrën urdhërore pa marrë mbaresën e kohës së tashme, sepse kjo mbaresë e lidh me foljen *ahmak*, veprimi i të cilës kryhet në të njëjtën kohë foljore, por nga kryefjalë të tjera që nënkuptohet nga mbaresa vetore *-im*:

[...mektubu Şerife Kadın’a ver de bana gönder, alırım.]

Nëse insistohet që mbaresat e kohës së tashme të mbesin, atëherë duhet të theksohen kryefjalët e tyre:

[...mektubu Şerife Kadın'a ver o bana gönderir, ben de alırım].

Për ta përmbyllur këtë pjesë të punimit dhe për të treguar se sa e ka njohur Sami Frashëri strukturën e fjalisë burimore turke, në fund të kësaj pjese të punimit tim, nga vepra "*Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat*" po nxjerr fjali të ndryshme: kohore, shkakore, qëllimore, mënyrore, lidhore-përcaktore etj.:

"Okurken gözyaşı çeşme gibi akar..." / "Gjatë leximit filluan t'i rrjedhin lotët si krua..."<sup>[150]</sup>

"Bu sözü işittiğim gibi, iğne elimden düştü" / "Sapo dëgjova këtë fjalë, gjilpëra më ra nga dora"<sup>[151]</sup>

"Kapının önünde gezinen tavukların, köpeklerin fişiltısını işittikçe..." / "Kur dëgjova lehen e qenve dhe kakarisjen e pulave para derës..."<sup>[152]</sup>

"Fitnat Hanım, bir taraftan, kederinden ağlamasından, bir taraftan da Tal'at Bey'i merak ettiğinden öbür iki günün içinde pek çok zayıflar,...."<sup>[153]</sup> / "Në këto ditë u dobësua shumë, ca nga vaji, e ca se u mërzit për Talatin..."

"...yavaş yavaş kalkıp gözlerimi kımıldatmaksızın savuştum."<sup>[154]</sup> / "...pas pak u ngrita ngadalë dhe, pa rrahur qepallat, dola"

"Hatta dün pederime seni sevdiğimi söyledim de... benimle güldüler"<sup>[155]</sup> / "...sa që dje i tregova edhe babait për dashurinë ndaj teje... qeshën me mua."

"Bir dakika geçer-geçmez annem koşarak ve ağlayarak gelir"<sup>[156]</sup> / "Nuk kaloi as një minutë, e nëna erdhi me vrap duke qarë"

"İnşallah, Cenab-i Hakk iki genç adamın kanının dökülmesine razı olmaz."<sup>[157]</sup> / "Shpresoj që Zoti nuk do të pajtohet të derdhet gjaku i dy të rinjve"

## Përfundim

Në roman është ilustruar edhe e folmja lokale. Sa jemi në dijeni, vepra nuk është trajtuar gjerësisht nga aspekti gjuhësor, prandaj kemi zgjedhur këtë temë si objekt të studimit tonë. Analiza gjuhësore

e veprës së këtij autori, i cili ka kontribuar shumë në zhvillimin e gjuhës turke, është bërë duke u mbështetur në rregullat gjuhësore të turqishtes së sotme, por edhe duke marrë parasysh kohën kur është shkruar (1872); është bërë në tri rrafshe gramatikore: leksikologji, morfologji dhe sintaksë. Janë dy tipat e fjalive në turqishten e Samiut: tipi tradicional turk dhe ai indoeuropian ku shfaqet ndikimi i gjuhës shqipe; përdorimi i shpeshtë i fjalive të ndërtuara me përemrin lidhor *ki* është edhe një shenjë ndikimi i gjuhës shqipe, gjuhës amtare. Sami Frashëri, me gjuhën e tij të thjeshtë, letërsisë turke i solli një gjini të re letrare (romanin) dhe risi të shumta gjuhësore, si tipin indoeuropian të fjalive, të cilat do të jenë pjesë e pandashme e krijimeve të brezit të ri.

### Literatura e shfrytëzuar:

1. Agah Sırrı Levend, *Türk Dilinde gelişme ve sadeleşme evreleri*, TDK, Ankara 1972
2. Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë 1983,
3. Azra Kasumović, *Priručnik osmansko-turskog jezika*, Sarajevo, 1991
4. Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë, 2001, Doğan Aksan, Her Yönüyle Dil, Ana Çizgileriyle Dilbilim, I-II TDK yay. Ankara 1982
5. Ferit Devellioğlu, *Osmanlıca-Türkçe Ansiklopedik Lugat*, Ankara, 1970
6. Grup autoresh, *Okul sözlüğü*, TDK, Ankara, 2000
7. Jasna Šamić, *Tendencije u savremenom turskom jeziku, Prilozi za orijentalnu filologiju*, 27/1977, Sarajevo, 1979
8. Mehdi Polisi, *Gramatika e gjuhës turke*, Logos, Prishtinë, 2002.
9. Mehmet Hengirmen, *Türkçe Dilbilgisi*, Engin Yayınevi, Ankara, 2005.
10. Sami Frashëri, *Dashuria e Talatit me Fitnetin*, Shkup, Logos, 2002.
11. Sami Neziri, *Fjalor turqisht-shqip*, Tiranë, 2003.
12. Sapir, Edward. 1921. *Language*. New York: Harcourt, Brace Jovanovich.
13. Şemsettin Sami, *Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat*, Ankara, 1979.
14. Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën Shqipe*, Tiranë, 2005.
15. Yrd. Doç. Dr. Münir Erten, *İlgi zamiri ve İyelik Zamiri Terimleri Üzerine*, (Sur Les termes des Pronom Relatif et Pronom Possessif) Elektronik Sosyal Bilimler Dergisi -Internet Google